



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË
QENDRA BURIMORE PËR NXËNËSIT QË NUK DËGJOJNË TIRANË

Rruga "Hafëz Ibrahim Dalliu" Nd.5 ; Tel 069 608 2456 ; Email: institutinxnukdegjojne@yahoo.com

Nr. Prot. 165

Tiranë, më 12 / 11 / 2025

URDHËR

PËR SHPALLJEN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

QENDRA BURIMORE PËR NXËNËSIT QË NUK DËGJOJNË TIRANË
lajmëron për 1 (një) vend pune i lirë në pozicionin **mësues i modulit profesional**
"Zdrukthtari".

Të gjithë të interesuarit për pozicionin e punës "Mësues" duhet të paraqesin pranë drejtorisë së QENDRËS BURIMORE PËR NXËNËSIT QË NUK DËGJOJNË TIRANË, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. CV (sipas modelit europass) dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV
2. Minimalisht diplomën e shkollës së mesme për përpunim druri (në përputhje me nevojat specifike për këtë vend të veçantë pune); minimalisht certifikimin në kursin **"Zdrukthtari"**.
3. Certifikata të Gjuhës së shenjave ose njohuri të avancuara të përdorimit të programeve të teknologjisë asistive për nxënës të nuk dëgjojnë.
4. Certifikata të pjesëmarrjes në trajnime lidhur me njohuritë në legjislacionin për të drejtat e aftësisë së kufizuar, parimet e përkujdesjes, ruajtjes së shëndetit dhe përdorimit të mjeteve të teknologjisë edukative për komunitetin e njerëzve që nuk flasin e nuk dëgjojnë
5. Raportin mjeko-ligjor
6. Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të kandidatit/kandidates. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).
7. Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.
8. Dokumentet të jenë foto të noterizuara ose origjinale.

Përveç sa më sipër kandidatët të plotësojnë kërkesat që vijojnë:

- Të kenë përvojë edhe/ose njohuri bazike për gjuhën e shenjave, sipas përcaktimeve në Pikat 13 dhe 14, të Kreut II, Të VKM-së Nr. 1074, datë 23.12.2015, Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- Të jenë të gatshëm të vizitojnë vendin e punës dhe të ndjekin trajnimin paraprak për të kuptuar nevojat specifike të sipërcituara.

Mënyra e përzgjedhjes/kualifikimit të kandidatëve

- Përzgjedhja/kualifikimi i kandidatëve do të kryhet e ndarë në 2 faza si më poshtë:
 - 60 pikë nga vlerësimi i dokumentacionit të sipërcituar të depozituar nga kandidatët në institucion, nga komisioni i vlerësimit i ngritur për këtë qëllim;
 - 40 pikë nga intervistimi me gojë i kandidatëve nga komisioni i vlerësimit, të cilët do të vlerësohen në lidhje me:
 - 15 pikë nga njohurite, aftesitë në lidhje me punën;
 - 15 pikë nga eksperiencat e tyre të mëparshme;
 - 10 pikë nga motivimi, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për punën;
- Si eksperiencë në profesion, e cila vlerësohet me max. 10 pikë, do të konsiderohet **VETËM eksperiencia në profesion.**

Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit:

- Dokumentacioni do të dorëzohet në zyrën e arkiv-protokollit të institucionit, personalisht ose me postë, brenda orarit zyrtar të punës (e hënë- e premte nga ora 08.00 - 14.00), në adresën: Qendra Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë, Rruga e Dibrës (pranë Medresesë), Tiranë;
- Dokumentacioni duhet të dorëzohet me postë ose dorazi nga aplikanti, në zyrën e arkiv protokollit të institucionit brenda afatit të përcaktuar për dorëzim/pranimin e dokumentacionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit:

- Afati maksimal i dorëzimit/pranimin të dokumentacionit nga zyra e arkiv-protokollit të institucionit do të jetë (2) dy javë kalendarike, nga dita e nesërme e shpalljes së njoftimit në faqen e webit të QBNND-së: www.nxenesitqenukddegjojne.edu.al në rubrikën respektive: Vende të Lira Pune.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë data 26 / 11 / 2025, ora 14:00.

Brenda 2 (dy) ditëve pune, pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, kandidatët njoftohen mbi vlerësimin e Fazës I si dhe mbi vendin, datën dhe orën e zhvillimit të Fazës II (intervista me gojë). Kandidatët kanë të drejtën e ankimit të vlerësimit brenda dy ditëve që nga marrja e njoftimit. Ankesa bëhet në adresën elektronike zyrtare të institucionit.

6 Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri Sektori i arkivës dhe sekretarisë pranë institucionit;

7 Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR

ORJOLA IDRIZI Dr. Proc.

